



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-066
Prishtinë, më 9 qershor 2016

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 9 QERSHOR 2016**

Seancën e drejtoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave të rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxheri, Visar Ymeri, Nenad Rashiq, Blerta Deliu, Armend Zemaj, Donikë Kadaj-Bujupi, Zenun Pajaziti, Veton Berisha, Glauk Konjufca, Xhevaire Izmaku, Vjosa Osmani, Shpejtim Bulliqi dhe Faton Topalli, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, në lidhje me atë se sa ka ndikuar Ligji për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të Kosovës në zvogëlimin e numrit të të rinjve nga Kosova për t'iu bashkuar luftës në Siri.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetes Alma Lama.

Deputeti Raif Qela i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e Qeverisë së Kosovës për kthimin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës, të dëbuar nga pronat e veta, për t'u kthyer në banesat dhe shtëpitë e tyre në komunën e Mitrovicës Veriore?

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me arsyet e procedimit të Projektligjit nr. 05/L-099 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me qëndrimet e tij për Marrëveshjen për Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me pranimin e “Kartonit të Gjellbërt” për makinat e mërgimtarëve të Kosovës që do të kthehen në vendlindje gjatë pushimeve verore.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me angazhimin e disa ministrave në Kabinetin qeveritar për pranimin e Kosovës në UNESCO, UEFA dhe FIFA, si dhe brohoritjet e tyre gjatë fushatës zgjedhore të Serbisë, që janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Arsim Bajrami, lidhur me veprimet e ministrisë për ndryshimin dhe reformimin e teksteve shkollore për shkollat fillore.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Besa Baftiu i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me qëndrimin e kësaj ministrie për grevën e punëtorëve të sigurimit në Spitalin Rajonal të Gjilanit.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftiu i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me veprimet e kësaj ministrie për zbatimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Salih Salihu i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, lidhur me ndërtimin e një lidhjeje për qytetarët e komunës së Vitisë në autostradën Prishtinë-Han i Elezit.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Pati edhe pyetje të tjera, por për mungesë të ministrave ato u shtynë për seancën e radhës.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 28 dhe 29 prill, më 18 dhe 25 maj, si dhe më 25 maj 2016.

* * *

Deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV, propozoi që në rend dite të seancës së sotme të radhitet edhe propozimi i këtij grupi parlamentar për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartshënuar që të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi Projektligjit nr. 05/L-093 për ratifikimin e Konventës për heqjen e Kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961)

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisionit për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e Kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961) dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ai i njoftoi deputetët për procedurën e shqyrtimit dhe të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat duhet votuar së paku 80 deputetë “për”.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri Arban Abrashi para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi projektligjin.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e Kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961) diskutuan këta deputetë: Teuta Rugova në emër të Komisionit për Punë të Jashtme dhe të GP të LDK-së; Blerta Deliu, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër GP LVV; Slavko Simiq, në emër të GP LS dhe Qerim Bajrami, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 83,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e Kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961).

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisionit për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe

Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri Abdullah Hoti para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi projektligjin.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale diskutuan këta deputetë: Naser Osmani, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa; Labinotë Demi-Murtezi, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Visar Ymeri, në emër GP LVV; Slavko Simiq, në emër të GP LS dhe Fikrim Damka, në emër të GP “6+”, si dhe Armend Zemaj, Shqipe Pantina dhe Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----23,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisionit për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri Abdullah Hoti para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi projektligjin.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale diskutuan këta deputetë: Naser Osmani, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe të GP të LDK-së; Labinotë Demi-Murtezi, në emër të GP të PDK-së; Visar Ymeri, në emër GP LVV; Slavko Simiq, në emër të GP LS dhe Fikrim Damka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Visar Ymeri deklaroi se deputetët e GP të LVV do të abstenojnë gjatë votimit të këtij projektligji.

Deputeti Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që votimi i këtij projektligji të shtyhet për seancën e radhës.

Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale të shtyhet për seancën e radhës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kuvendi se në seancën plenare, të mbajtur më 25 maj 2016, e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe i ka miratuar amendamentet e propozuara: 1, 3, 4, 5 dhe 6.

Ndërsa për mungesë të kuorumit për vendimmarrje ka mbetur pa u miratuar amendamenti nr. 2 dhe teksti i Projektligjit me amendamentet e miratuara. Me propozim të zëvendëskryeministrit, z. Kujtim Shala, procedimi i mëtejshëm i këtij projektligji është shtyrë për seancën e sotme.

Andaj, në seancën e sotme procedohet vetëm me votimin e amendamentit nr. 2 dhe të tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lidhur me këtë projektligj diskutuan këta deputetë: Albulena Haxhiu, Jelena Bontiq, Alma Lama dhe Vjosa Osmani-Sadriu, diskutimet e të cilave janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim amendamentin nr. 2, të cilin me shumicë votash e miratoi Kuvendi.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----51,
Kundër ----- 18,
Abstenime ----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-083 për falimentimin

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për falimentimin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Fatmir Rexhepi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit lidhur me këtë projektligj. Në këtë projektligj ishin paraqitur 59 amendamente.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara, sipas radhës së paraqitur nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18,19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 3, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 (i riformuluar sipas propozimit të deputetit Fatmir Rexhepi), 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56 57, 58 dhe 59.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, propozoi amendament të ri, nr. 60, me tekstin në vijim: “Të bëhet korrektimi gjuhësor dhe i barasvlershëm në tri gjuhët në gjithë tekstin e këtij ligji”. Por, propozimi i tij nuk u hodh në votim.

Në fund, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 67,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-083 për falimentimin.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për falimentimin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Muhamet Mustafa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit lidhur me këtë projektligj. Në këtë projektligj ishin paraqitur 35 amendamente.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara, sipas radhës së paraqitur nga Komisioni Funksional.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18,19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Ndërsa, për amendamentin 32 ishin dy propozime: 32A i Komisionit funksional dhe 32B i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Lidhur me këtë amendament diskutuan: Naser Osmani, Arben Gashi, Besim Beqaj, Muhamet Mustafa dhe ministrja Hykmete Bjrani.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, propozoi që ky projektligj të kthehet edhe një herë në rishqyrtim në komisionin funksional.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryeministrit.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Kërkohej nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta rishqyrtojnë Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës me amendamentet e propozuara dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit, zv/kryetarit dhe tre (3) anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për mosmiratim.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-vendimin e Qeverisë emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe tre (3) anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë propozimin e Qeverisë.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, z. Muhamet Mustafa e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës diskutoi edhe deputeti Raif Qela.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 43,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 10.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurencës emërohen:

1. Valon Prestreshi, kryetar,
2. Ahmet Krasniqi, zëvendëskryetar,
3. Fatime Haziri, anëtare,
4. Muhamed Krasniqi, anëtar dhe
5. Shaqir Morina, anëtar.

Kryesuesi dha pauzë për drekë deri në orën 15:00.

Pas pauzës, Kuvendi i zhvilloi punimet me pikat e tjera të rendit të ditës.

11. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 dhe i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetja Besa Gaxheri e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 diskutuan edhe këta deputetë: Abdyl Ymeri, në emër të GP të PDK-së, Blerim Grainca, në emër të GP të PDK-së, Visar Ymeri, në emër të GP LVV, diskutimet e cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015.

12. Shqyrtimi i raportit të punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL, deputetja Emilija Rexhepi e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Besa Gaxherri e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për raportin vjetor të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015 diskutuan edhe këta deputetë: Emilija Rexhepi, në emër të GP të PDK-së dhe Adem Salihaj, në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri, diskutimet e cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin e punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Raportin e punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015.

* * *

Kryetari i Grupit Parlamentar, Adem Grabovci, propozoi që dy pikat e rendit ditës: a) Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave dhe b) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës të shtyhen për seancën e radhës.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që dy pikat e lartpërmendura të rendit të ditës të shtyhen për seancën e radhës.

14. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Kuvendi, me propozimin e Grupit Parlamentar Lista serbe mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Adem Hoxha emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, në vend të deputetit Nenad Rashiq.

15. Propozimi i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kuvendi, me propozimin e Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, mori këtë:

V E N D I M

I. Nga Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” bëhen këto zëvendësime në komisionet parlamentare:

1. Deputeti Faton Topalli emërohet Kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.
2. Deputeti Glauk Konjufca emërohet zëvendëskryetar i parë i Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetit Visar Ymeri.
3. Deputetja Puhie Demaku emërohet anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Glauk Konjufca.
4. Deputetja Donika Kada-Bujupi emërohet anëtare e Komisionit për Integritet Evropian.
5. Deputetja Shqipe Pantina emërohet anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 16:10 minuta.

Kryesuesi i seancës
Xhavit Haliti

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale